

PROF. ASOC. DR. FLUTURA KOLA TAJAJ
DR. SILVANA ÇINARI

**PËRFITIMI I SHQIPËRISË NGA
RATIFIKIMI I KONVENTËS SË HAGËS
SË 2019 “PËR NJOHJEN DHE
EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE
GJYQËSORE CIVILE DHE TREGTARE”
 (“KONVENTA E VENDIMEVE E
HCCH2019”)**



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I SË DREJTËS CIVILE**



Projekt “Rëndësia e ratifikimit nga Shqipëria të Konventës së Hagës së 2019 “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në çështjet civile dhe tregtare” (Konventa e Vendimeve e HCCH 2019)”, financuar nga Programi “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion” i Universitetit të Tiranës, Maj 2023 – Shkurt 2024

RAPORT

PËRFITIMI I SHQIPËRISË NGA RATIFIKIMI I KONVENTËS SË HAGËS SË 2019 “PËR NJOHJEN DHE EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE CIVILE DHE TREGTARE” (“KONVENTA E VENDIMEVE E HCCH2019”)

Prof. Asoc. Dr. Flutura Kola Tafaj

Dr. Silvana Çinari

SHKURT, 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTIME

I. HYRJE.....	1
1.1 Objekti.....	1
1.2 Metodologjia	1
II. INSTRUMENTE NDËRKOMBËTARË NË LIDHJE ME NJOHJEN DHE/OSE EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE	3
III. REGJIMI AKTUAL I NJOHJES DHE/OSE EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE CIVILE DHE TREGTARE SHQIPTARE JASHTË SHTETIT.....	4
3.1 Mundësia e njohjes dhe/ose ekzekutimit të vendimeve civile dhe tregtare shqiptare në Gjermani.....	5
3.2 Mundësia e njohjes dhe/ose ekzekutimit të vendimeve civile dhe tregtare shqiptare në Austri.....	8
3.3 Mundësia e njohjes dhe/ose ekzekutimit të vendimeve civile dhe tregtare shqiptare në Itali.....	9
3.4 Mundësia e njohjes dhe/ose ekzekutimit të vendimeve civile dhe tregtare shqiptare në Greqi.....	10
IV. SAGA E NJOHJES SË NJË VENDIMI TREGTAR SHQIPTAR NË DISA SHTETE TË EVROPËS.....	11
4.1 Njohja e vendimit gjyqësor shqiptar në çështjen <i>ABA kundër Enel SpA</i> në Qarkun e Nju Jorkut, SHBA.....	11
4.2 Njohja e vendimit gjyqësor shqiptar në çështjen <i>ABA kundër Enel SpA</i> në Irlandë.....	13
4.3 Njohja e vendimit gjyqësor shqiptar në çështjen <i>ABA kundër Enel SpA</i> në Holandë.....	14
4.4 Njohja e vendimit gjyqësor shqiptar në çështjen <i>ABA kundër Enel SpA</i> në Francë.....	15
V. REGJIMI AKTUAL I NJOHJES DHE/OSE EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE TË HUAJA CIVILE DHE TREGTARE NË SHQIPËRI.....	15
VI. REGJIMI I PRITSHËM I NJOHJES DHE/OSE EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE CIVILE DHE TREGTARE PAS RATIFIKIMIT TË KONVENTËS SË VENDIMEVE.....	18
6.1 Njohja dhe/ose ekzekutimi i vendimeve gjyqësore shqiptare në vende të huaja dhe anasjelltas do të jetë i parashikueshëm.....	18
6.2 Njohja dhe/ose ekzekutimi i vendimeve shqiptare do të jetë konsistente.....	19
6.3 Konventa tenton të theksojë juridiksionin ekskluziv në lidhje me pronën reale... ..	20
6.4 Ratifikimi i Konventës do të shmangë zbatimin e nenit 394(ç) të KPC-së.....	20
6.5 Regjimi më i favorshëm për njohjen dhe zbatimin e vendimit të huaj.....	21
6.6 Juridiksioni i gjykatës ku është kërkuar njohja	21
VII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	22
BIBLIOGRAFI.....	23

SHKURTIME

BE – Bashkimi Evropian

Konventa e Luganos - Konventa e Luganos e 2007 “Mbi Juridiksionin dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare” ndërmjet Komunitetit Evropian, Zvicrës, Norvegjisë, Islandës dhe Danimarkës.

Konventa e Vendimeve HCCH 2019 - Konventa e Hagës e 2 korrik 2019 “Mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile dhe tregtare”

Konventa e Nju Jorkut – Konventa e Nju Jorkut për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj e 1958, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8688, datë 9.11.2000.

KPC – Kodi i Procedurës Civile

Rregullorja e Brukselit 1215/2012 - Rregullore e (BE) Nr 1215/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 dhjetor 2012 për Juridiksionin dhe Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në Çështjet Civile dhe Tregtare

ZPO – Kodi Gjerman i Procedurës Civile

I. HYRJJE

1.1 Objekti

Ky studim është produkt i projektit “Rëndësia e ratifikimit nga Shqipëria të Konventës së Hagës së 2019 “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në çështjet civile dhe tregtare” (Konventa e Vendimeve e HCCH 2019)”, të financuar nga Programi “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion” i Universitetit të Tiranës, i cili ashtu sikurse titulli e dikton, synon të evidentojë rëndësinë e ratifikimit nga Shqipëria të Konventës së Hagës së 2019 “Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja në Çështjet Civile dhe Tregtare”, (e njohur ndryshe si Konventa e Vendimeve e HCCH 2019)” e cila ka hyrë në fuqi më 1 shtator 2023.¹

Meqenëse marrëdhëniet civile dhe tregtare të personave fizikë dhe juridikë shqiptarë me persona të huaj janë intensifikuar dekadat e fundit, edhe numri i vendimeve të gjykatave të huaja dhe shqiptare që zgjidhin mosmarrëveshje që lindin nga këto marrëdhënie me elementë të huaj është rritur. Mundësia e ekzekutimit të këtyre vendimeve gjyqësore edhe në shtete të huaja është thelbësore për të garantuar aksesin në drejtësi në mënyrë efektive. Për rrjedhojë, qëllimi i këtij studimi është që, duke analizuar kuadrin ligjor ekzistues dhe praktikën gjyqësore në Shqipëri, në disa shtete të huaja lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të huaja, të evidentojë *së pari*, nëse mundësia e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare të gjykatave të huaja në Shqipëri dhe e atyre shqiptare jashtë është efektive dhe *së dyti*, si mund të ndikojë ratifikimi nga Shqipëria i Konventës së Vendimeve të HCCH 2019 në përmirësimin e kushteve për lehtësimin e ekzekutueshmërisë së vendimeve gjyqësore shqiptare jashtë dhe anasjelltas.

Pra, në mënyrë të përmbledhur, studimi synon të evidentojë: (i) efektivitetin e kuadrit ligjor aktual shqiptar në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore (*civile dhe tregtare*) të huaja dhe të kuadrit ligjor të disa shteteve të huaja, kryesisht evropiane, në garantimin e njohjes së vendimeve të gjykatave shqiptare në çështjet civile dhe tregtare; dhe (ii) mundësinë e lehtësimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile dhe tregtare nëpërmjet ratifikimit nga Shqipëria të Konventës së Vendimeve të HCCH 2019.

1.2 Metodologjia e studimit

Në studim është përdorur një metodë e përzier kërkimore, duke kombinuar metodologji kërkimore cilësore dhe sasore, të cilat synojnë mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të kuptuar më mirë regjimin juridik të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja në Shqipëri dhe të vendimeve shqiptare në shtete të huaja. Hulumtimi me metodë të përzier ka ndjekur “modelin shpjegues sekuencial”, në të cilin fillimisht janë mbledhur dhe analizuar të dhënat sasore dhe më pas rezultatet sasore fillestare janë shpjeguar më në detaje me metodat e kërkimit cilësor.

¹ <https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/?cid=137>

Përgatitja për zbatimin e projektit ka filluar me mbledhjen e parë të grupit të punës për ndarjen e detyrave lidhur me kërkimin shkencor. Kjo mbledhje u pasua me përzgjedhjen e një grupi studentësh nga Fakulteti i Drejtësisë (5 studentë) që asistuan në kërkim lidhur me kuadrin ligjor dhe jurisprudencën shqiptare dhe të huaj mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave shqiptare në vende të huaja dhe të vendimeve të huaja në Shqipëri. Studentët e angazhuar në kërkim shkencor ishin: Klaudjon Laska, Amarildo Bregasi, Nikolin Mucaj, Alesia Vrenozi, Esmeralda Metko.

Në datën 31 Korrik 2023 u zhvillua trajnimi i studentëve mbi mënyrën e kërkimit lidhur me kuadrin ligjor dhe jurisprudencën shqiptare dhe të huaj dhe ndarjen e detyrave mes tyre. Secili nga studentët bëri kërkim mbi fushën e studimit në lidhje një shtet të caktuar, përkatësisht: Klaudjon Lasa – Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve shqiptare në Gjermani dhe anasjelltas; Amarildo Bregasi - Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve shqiptare në Itali dhe anasjelltas; Nikolin Mucaj - Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve shqiptare në ShBA dhe anasjelltas; Alesia Vrenozi dhe Esmeralda Metko – Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve shqiptare në Greqi dhe anasjelltas.

Në fazën e kërkimit shkencor studentët janë përqendruar në (i) kërkimin dhe studimin e legjislacionit të brendshëm dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe që Shqipëria ka me shtetin e përzgjedhur prej secilit për tu analizuar; (ii) kërkimin e literaturës (*dhe studimin e saj*) mbi Konventën e Vendimeve të HCCH 2019; (iii) kërkimin e praktikës gjyqësore shqiptare. Studentët i dorëzuan rezultatet e kërkimit të tyre brenda datës 20 Shtator 2023. Më pas, anëtarët e grupit të punës, Prof. Asoc. Dr. Flutura Kola Tafaj, Dr. Silvana Çinari dhe Kandidatja për Doktore Entela Memishaj rishikuan, diskutuan dhe seleksionuan rezultatet e kërkimit shkencor të studentëve, realizuan kërkim shkencor shtesë dhe përcaktuan strukturën e raportit, me qëllim vijimin në fazën tjetër të projektit atë të hartimit të raportit dhe organizimit të aktiviteteve të tjera të parashikuara në projekt.

Në fazën e përgatitjes së raportit, Prof. Asoc. Dr. Flutura Kola Tafaj dhe Dr. Silvana Çinari u përqendruan në: (i) Analizën e kuadrin ligjor dhe jurisprudencës shqiptare dhe të huaj mbi njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja, dhe vlerësimin e efektivitetit të kuadrin ligjor ekzistues për të garantuar njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja. (ii) Analizën e Konventës së Hagës 2019 “Mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile dhe tregtare”, e literaturës ekzistuese mbi këtë Konventë, si dhe qëllimeve dhe efekteve të pritshme nga ratifikimi i Konventës së 2019 në lidhje me lehtësimin e kushteve për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të huaja në çështjet civile dhe tregtare; (iii) Nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve lidhur përparësitë që mund të sjellë ratifikimi nga Shqipëria i Konventës së Vendimeve të HCCH 2019.

Pas hartimit të draftit të parë të raportit, me qëllim informimin e grupeve të interesit, janë organizuar aktivitetet e mëposhtme:

- i. Workshop me përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, gjyqësori, akademia, avokatia etj. për informimin e tyre me gjetjet paraprake të raportit dhe shkëmbimin e mendimeve

me qëllim pasurimin e rekomandimeve të raportit përpara publikimit të tij në faqen e internetit të Fakultetit të Drejtësisë, UT (31 Janar 2024);

- ii. Leksion i hapur me studentë dhe të interesuar nga shoqëria/publiku për informimin e tyre me gjetjet e raportit dhe publikimi i raportit në faqen e internetit të Fakultetit të Drejtësisë, UT (22 Shkurt 2024).

II. INSTRUMENTE NDËRKOMBËTARË NË LIDHJE ME NJOHJEN DHE/OSE EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE

Ndryshe nga Konventa e Nju Jorkut për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj e 1958,² që konsiderohet një nga Konventat më të suksesshme të Kombeve të Bashkuara, nuk ka pasur ndonjë instrument të suksesshëm global që rregullon njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në çështjet civile dhe tregtare ndërkufitare. Me propozim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vitin 1992, Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private ka miratuar Konventën për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja për Çështjet Civile ose Tregtare më 2 korrik 2019, e cila ka hyrë në fuqi më 23 Shtator 2023. Konferenca e Hagës kishte miratuar më parë një Konventë tjetër për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja në Civil dhe Çështjet Tregtare (1 shkurt 1971), e cila rezultoi e pasuksesshme, pasi u ratifikua vetëm nga pesë shtete kontraktuese: Shqipëria, Holanda, Kuvajti, Qiproja dhe Portugalia. Arsyet thelbësore të mospasjes së kësaj Konvente konsiderohen mungesa e rregullave mbi juridiksionin dhe neni 21 i saj, i cili përcakton se: “Vendimet e marra në një shtet kontraktues nuk do të njihen ose zbatohen në një shtet tjetër kontraktues në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, përveç rastit kur të dy shtetet, duke qenë Palë në këtë Konventë, kanë lidhur një Marrëveshje Suplementare për këtë qëllim.” Kjo kërkesë shtesë rezultoi një barrë e panevojshme dhe nuk ndihmoi në arritjen e qëllimit të Konventës. Konventa e re e Vendimeve të HCCH 2019 e ka hequr këtë barrierë.

Më 1 tetor 2015 ka hyrë në fuqi Konventa për Zgjedhjen e Juridiksionit me Marrëveshje e 30 qershorit 2005, e cila zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të dhënë nga një gjykatë e një shteti kontraktues, juridiksioni i së cilës është caktuar në bazë të një marrëveshje juridiksioni ekskluziv mes palëve. Përveç shteteve anëtare të BE-së, kontraktore të kësaj Konvente janë edhe Britania e Madhe, Singapori, Meksika, Ukraina. Ndërsa shtetet që e kanë nënshkruar, por për të cilat Konventa nuk ka hyrë ende në fuqi janë: Kina, Izraeli, SHBA, Maqedonia e Veriut dhe së fundmi Shqipëria, më datë 13.02.2024.³

Disa shtete kanë ratifikuar instrumente të shumta dypalëshe, rajonale dhe ndërkombëtare, por këto instrumente shpesh kanë fushë zbatimi dhe/ose shtrirje territoriale të kufizuar.⁴ Për shembull, në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja në çështjet civile dhe tregtare rregullohet nga Rregullorja e Brukselit për Juridiksionin dhe Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në Çështjet Civile dhe Tregtare

² Ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8688, datë 9.11.2000.

³ <https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/?cid=98>

⁴“Përmbledhje e Projektit të Vendimeve”, shih <https://www.hcch.net/en/projects/legislative-projects/judgments/overview-judgments>.

(20/44), e ndryshuar në nëntor 2012. Rregullorja e ndryshuar, e quajtur Rregullorja e BE-së 1215/2012, është në fuqi që nga janari 2013, por ajo zbatohet vetëm për procedurat ligjore të filluara më 10 janar 2015 ose pas saj. Sipas Rregullores së Brukselit 1215/2012, vendimet e dhëna në një Shtet Anëtar duhet të njihen në të gjitha Shtetet Anëtare pa pasur nevojë për ndonjë procedurë të veçantë. Si rezultat, një vendim i dhënë nga gjykatat e një Shteti Anëtar duhet të trajtohet ashtu siç ishte dhënë në Shtetin Anëtar të adresuar (*preambula 26*). Në Bashkimin Evropian, disa rregullore të tjera gjithashtu parashikojnë dispozita në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me disa procedura të veçanta, për shembull, Rregullorja EC 861/2007 - Mbi Procedurat Evropiane të Padive të Vogla; Rregullorja EC 1896/2006 – Procedura e Urdhrit Evropian për Pagesë.

III. REGJIMI AKTUAL I NJOHJES DHE/OSE EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE CIVILE DHE TREGTARE SHQIPTARE JASHTË SHTETIT

Duke qenë se Shqipëria nuk është ende një Shtet Anëtar i BE-së, Rregullorja e Brukselit 1215/2012 nuk është e zbatueshme për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve civile ose tregtare shqiptare jashtë vendit. Prandaj, njohja dhe zbatimi i vendimeve shqiptare në Shtetet Anëtare të BE-së mbetet subjekt i rregullave kombëtare, pra atyre në fuqi në çdo Shtet Anëtar.

Shqipëria ka nënshkruar së fundmi, më 13.02.2024, Konventën e 30 qershorit 2005 mbi Zgjedhjen e Juridiksionit me Marrëveshje, megjithatë ajo nuk ka hyrë ende në fuqi, dhe për rrjedhojë aktualisht edhe kjo Konventë është e pazbatueshme për njohjen e vendimeve gjyqësore shqiptare në shtetet kontraktore të saj. Konventa e Hagës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në vendimet civile dhe tregtare, e lidhur më 1 shkurt 1971 është në fuqi dhe është ratifikuar nga Shqipëria më 8 prill 2010 (*midis 4 shteteve të tjera*)⁵. Neni 21 i kësaj Konvente⁶ kërkon lidhjen e një Marrëveshjeje Suplementare ndërmjet shteteve për ta bërë të zbatueshme Konventën. Shqipëria nuk ka ratifikuar “Protokollin Plotësues të 1 shkurtit 1971 të Konventës së Hagës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja në Çështjet Civile dhe Tregtare”, i cili është lidhur sipas nenit 21 të Konventës së sipërpërmendur dhe nuk ka lidhur asnjë marrëveshje plotësuese për këtë qëllim. Prandaj, edhe kjo Konventë nuk është e zbatueshme për njohjen e vendimeve shqiptare në shtetet kontraktore të saj.

Shqipëria ka nënshkruar disa marrëveshje dypalëshe të cilat përfshijnë dispozita për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve civile dhe tregtare. Këto marrëveshje dypalëshe janë:

1. Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për Ndihmën Juridike të Ndërsjellë në Çështjet Civile, ratifikuar me Ligjin nr. 9348, datë 24.02.2005.
2. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë për ndihmë juridike në fushën e çështjeve civile dhe penale, nënshkruar më 15.01.1998.

⁵ Qipro, Kuvajti, Holandë, Portugali. Shiko: <https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/?cid=78>

⁶“Vendimet e marra në një Shtet Kontraktues nuk do të njihen ose ekzekutohen në një Shtet tjetër Kontraktues në përputhje me dispozitat e neneve të mëparshme, përveç rastit kur të dy shtetet, duke qenë Palë në këtë Konventë, kanë lidhur një Marrëveshje Plotësuese për këtë qëllim.”

3. Konventa për ndihmën e ndërsjellë në çështjet civile, tregtare dhe penale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, nënshkruar më 15.03.1995.
4. Protokoll i Shkëmbimit të Instrumenteve të Ratifikimit të Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Civile, Tregtare dhe Penale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, nënshkruar dhe në fuqi më 20.02.1998.
5. Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për Ndihmën Gjyqësore në Çështjet Civile dhe Penale, nënshkruar më 17.5.1993.
6. Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Federatës Ruse “Për ndihmën juridike në çështjet civile, penale dhe familjare”, ratifikuar me ligjin nr. 8061, datë 08.02.1996.
7. Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet civile, penale dhe familjare” Dekreti nr. 3250, datë 17.04.1961.
8. Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet civile, penale dhe familjare”, Dekreti nr. 3119, datë 06.06.1960.

Nga sa më sipër, mund të themi se, në Bullgari, Maqedoni, Turqi, Greqi, Rusi, Rumania dhe Hungari një vendim civil ose tregtar shqiptar mund të njihet dhe zbatohet sipas dispozitave të marrëveshjeve dypalëshe të sipërpërmendura, të cilat duhet thënë se janë jo bashkëkohore, të shkruara në një gjuhë shumë të varfër dhe në disa raste të pakuptueshme. Ndërsa, në të gjitha shtetet e tjera, me të cilat Shqipëria nuk ka marrëveshje dypalëshe të zbatueshme, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve civile dhe tregtare shqiptare do të ishte i mundur sipas dispozitave të ligjit të brendshëm të çdo shteti, të cilat, në skenarin më të mirë, janë të ndryshme nga shteti në shtet, të paparashikueshme dhe jokonsistente dhe, në rastin më të keq, e pamundësojnë njohjen dhe/ose ekzekutimin e vendimeve civile dhe tregtare shqiptare.

Për të analizuar këto mundësi, jemi fokusuar në regjimin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve shqiptare në disa shtete, si Gjermani, Austri, Itali dhe Greqi, me të cilët edhe aktiviteti ekonomik i shqiptarëve ka qenë domethënës dhe për rrjedhojë paraqet interes praktik.

3.1 Mundësia e Njohjes dhe/ose Ekzekutimit të Vendimeve Civile dhe Tregtare Shqiptare në Gjermani

Në lidhje me njohjen e vendimeve të huaja civile dhe tregtare, *(përveç rregulloreve të BE-së të cilat janë të zbatueshme për vendimet e BE-së)*, në Gjermani janë të zbatueshme edhe: (i) Konventa e Luganos e 2007 mbi Juridiksionin dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare ndërmjet Komunitetit Evropian, Zvicrës, Norvegjisë, Islandës dhe Danimarkës; (ii) Konventa e Hagës e 2005 mbi Zgjedhjen e Juridiksionit me Marrëveshje të palëve; (iii) Konventa e Vendimeve e HCCH e 2019. Gjithashtu, Gjermania ka lidhur shumë marrëveshje dypalëshe për njohjen reciproke dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja, por shumica e tyre janë bërë të panevojshme për shkak të mbizotërimit të rregulloreve të BE-së dhe konventave ndërkombëtare.⁷

⁷ Marrëveshjet më të rëndësishme vazhdojnë të jenë: 1) Marrëveshja midis Gjermanisë dhe Tunizisë 1966 për mbrojtjen ligjore, ndihmën juridike dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe

Shqipëria nuk ka lidhur asnjë marrëveshje dypalëshe për njohjen dhe/ose ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile ose tregtare me Gjermaninë dhe nuk është Shtet Kontraktues i Konventave të mësipërme të ratifikuara nga Gjermania, përveç Konventës së Hagës e 2005 mbi Zgjedhjen e Juridiksionit me Marrëveshje, e cila ende nuk ka hyrë në fuqi për Shqipërinë. Prandaj, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve civile dhe tregtare shqiptare në Gjermani bëhet sipas seksioneve 328, 722 dhe 723 të Kodit Gjerman të Procedurës Civile (“ZPO”). Sipas nenit 328 të tij, njohja e një vendimi të dhënë nga një gjykatë e huaj do të refuzohet nga gjykatat gjermane nëse:

- Gjykata e shtetit që ka dhënë vendimin e huaj nuk ka pasur juridiksion për shqyrtimin e çështjes sipas ligjit gjerman;
- Gjykimi është zhvilluar në mungesë të palës së paditur dhe nuk është njoftuar në mënyrë të rregullt për procesin ose nuk i është dhënë koha e nevojshme për të realizuar mbrojtjen;
- Vendimi është i papajtueshëm me një vendim të dhënë në Gjermani, ose me një vendim të mëparshëm të dhënë jashtë vendit që mund të njihet në Gjermani, ose nëse procesi mbi të cilat bazohet vendimi i huaj është i papajtueshëm me një proces të filluar më parë në Gjermani;
- Njohja e vendimit do të çonte në një rezultat që është dukshëm i papajtueshëm me parimet thelbësore të ligjit gjerman, dhe në veçanti nëse njohja nuk është në përputhje me të drejtat themelore; (p.sh., vendimi bie ndesh me të drejtat themelore sipas Kushtetutës ose jep dëmshpërblime ndëshkuese); ose
- **Reciprociteti nuk është i garantuar.** Ky rregull nuk zbatohet kur vendimi ka të bëjë me një pretendim jopasuror dhe nëse, sipas ligjeve të Gjermanisë, asnjë gjykatë gjermane nuk ka pasur juridiksion.

Në tërësinë e tyre pengesat e mësipërme ligjore që parashikon ligji gjerman për njohjen e një vendimi civil apo tregtar të huaj janë pak a shumë të ngjashme me ato që parashikon edhe ligji shqiptar apo ligjet e tjera të vendeve të BE-së. Përjashtimisht, meriton vëmendje kushti i reciprocitetit, i cili është një nga kriteret që duhet të plotësohet për qëllimin e njohjes së një vendimi të huaj në Gjermani. Nuk ka një interpretim të qartë në lidhje me zbatimin e këtij parimi nga gjykatat gjermane. Në përgjithësi, kjo kërkesë do të thotë që njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjermane në vendin e huaj të origjinës nuk duhet të jetë thelbësisht më i vështirë se sa njohja në Gjermani e një vendimi nga shteti i huaj. Nëse kjo kërkesë përmbushet duhet të përcaktohet rast pas rasti, në bazë të përjasjes së vendit të origjinës së vendimit për të cilin kërkohet njohja në Gjermani, në lidhje me njohjen e vendimeve gjermane.⁸

tregtare dhe arbitrazhin tregtar; dhe 2) Marrëveshja ndërmjet Gjermanisë dhe Izraelit 1977 mbi njohjen reciproke dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare. Megjithatë, marrëveshje të tjera dypalëshe mund të mbulojnë njohjen reciproke dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në raste të veçanta. Shiko: Markus Langen, Dr. Andreas Klein and Dominik Stier, Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve mbi vendimet e huaja – Gjermani 2023-2024, 31.03.2023, <https://iclg.com/practice-areas/enforcement-of-foreign-judgments-laws-and-regulations/germany>

⁸ Markus Langen, Dr. Andreas Klein and Dominik Stier, Procesi gjyqësor: Ekzekutimi i vendimeve të huaja në Gjermani, 2 korrik 2018, <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=f476bc5a-60f4-4f1a-9aad-22a5e11fb708>

Kështu, nëse vendi i origjinës së vendimit do të ishte Shqipëria, në kuadër të zbatimit të reciprocitetit do të duhej të vlerësohej nëse është e mundur që vendimet gjermane të ekzekutohen në Shqipëri. Faktikisht, një vendim gjerman civil ose tregtar njihet në Shqipëri sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja, të cilat nuk parashikojnë kriteret reciprociteti. Për rrjedhojë, ligji shqiptar nuk parashikon asnjë ndalim të posaçëm për njohjen e vendimeve të gjykatave gjermane, përveç ndalimeve të përgjithshme që vlejnë për çdo lloj vendimi të huaj. Po ashtu, *de facto*, gjykatat shqiptare kanë njohur vendime të gjykatave gjermane. Për shembull, Gjykata e Apelit Durrës me Vendimin Regj Nr.27 datë 05.12.2005, ka njohur një vendim të formës së prerë të Gjykatës Rajonale Bamberg të Gjermanisë të datës 06.03.2003 dhe 16.10.2003 në çështjen civile Gerling-Konzern Allhemeine, *Versicherungs Aktiengesellschaft kundrejt Agjencisë së Transportit të Spedicionit, Doganave dhe Transportit Dyrrahsped*. Vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është mbështetur në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile Shqiptare (*nenet 394-398*) pa marrë parasysh reciprocitetin.⁹

Nga kërkimet e bëra dhe diskutimet me profesorë gjermanë të së drejtës ndërkombëtare private,¹⁰ nuk ka praktikë gjyqësore të botuar në Gjermani (*as pro dhe as kundër reciprocitetit midis Gjermanisë dhe Shqipërisë*). Komentarë mbi Kodin e Procedurës Civile Gjermane, në kontekstin e § 328 të ZPO, përmbajnë një listë të vendeve me të cilat ekziston apo jo reciprociteti dhe në lidhje me Shqipërinë, duke iu referuar një botimi të Uka/Wietzorek në revistën IPRax 2011,¹¹ përcaktohet se reciprociteti nuk është i garantuar.¹²

Në lidhje me juridiksionin e gjykatave gjermane, sipas nenit 722 II ZPO, gjykatat gjermane marrin juridiksionin në lidhje me një kërkesë për njohjen dhe/ose ekzekutimin e vendimit të huaj nëse (i) i padituri ndodhet në Gjermani ose (ii) pasuria e të paditurit ndodhet në Gjermani.

⁹ Kundër këtij vendimi Agjencia e Transportit, Doganave dhe Transportit Dyrrahsped AL-Durrës ka ankimuar në Gjykatën e Lartë vetëm për shkaqe procedurale lidhur me çështjen nëse kjo shoqëri duhet të thirret apo jo nga Gjykata e Apelit Durrës si palë e tretë. Gjykata e Lartë me vendimin e datës 13 mars 2008 ka pushuar çështjen me arsyetimin se shoqëria e Agjencisë së Transportit, Doganave dhe Transportit Dyrrahsped AL-Durrës ka tërhequr ankimin.

¹⁰ Christa Jessel-Holst, Professore e së Drejtës Ndërkombëtare Private, në Institutin Max Planck në Hamburg, Gjermani.

¹¹ O. Uka & M. Wietzorek, *Anerkennung einer deutschen Ehescheidung durch das Appellationsgericht Tirana* (Gjykata e apelit Tiranë, S. 90), IPRax 2011. “Deri më sot, nuk është sqaruar përfundimisht nëse reciprociteti në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve - siç kërkohet nga Seksioni 328 Paragrafi 1 Nr. 5 ZPO dhe Seksioni 109 Paragrafi 4 FamFG - garantohet në marrëdhëniet e Gjermanisë me Shqipërinë. Nuk ka asnjë kërkesë për reciprocitet në rregullat aktuale shqiptare për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja. Megjithatë, me sa shihet, në literaturën në gjuhën gjermane nuk ka pasur praktikë gjyqësore për këtë çështje. Me vendimin e diskutuar të datës 12 prill 2010, Gjykata e Apelit Tiranë ka njohur tashmë në Shqipëri një vendim të AG Nuremberg, i cili trajtonte një divorc. Ndryshe nga ligji gjerman, ligji shqiptar nuk bën dallime sipas objektit të vendimit gjatë njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja. Për rrjedhojë, në bazë të këtij vendimi dhe legjislacionit autonom shqiptar, ky artikull argumenton se gjykatat gjermane mund të marrin në çdo rast një garanci reciprociteti në marrëdhëniet e tyre me Shqipërinë.” <https://www.iprax.de/de/inhalte/fruehere-hefte/2011-Heft-01.php>

¹² Rolf A. Schütze, *Das internationale Zivilprozessrecht in der ZPO*, de Gruyter, 2011, f. 133

<https://dokumen.pub/das-internationale-zivilprozessrecht-in-der-zpo-2-neu-bearb-aufl-9783110250848-9783110250831.html>

Duke iu referuar një raporti të zyrës ligjore White & Case LLP, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja në Gjermani është relativisht i lehtë për t'u siguruar në rastet kur rregulloret ndërkombëtare ose konventat shumëpalëshe ose dypalëshe mbulojnë njohjen dhe ekzekutimin reciprok. Kjo vlen veçanërisht për vendimet e nxjerra nga gjykatat e shteteve anëtare të BE-së. Përveç këtij skenari, në rastet e tjera (*si rasti i vendimeve gjyqësore shqiptare*), njohja dhe ekzekutimi mund të jetë i vështirë dhe kërkon shumë kohë, duke qenë se gjykatat duhet të vlerësojnë aspekte të ligjit të huaj me të cilat nuk janë të njohura.¹³

3.2 Mundësia e Njohjes dhe/ose Ekzekutimit të Vendimeve Civile dhe Tregtare Shqiptare në Austri

Një vendim civil ose tregtar i lëshuar nga një gjykatë e një vendi në të cilin nuk aplikohet Rregullorja BE 1215/2012, Konventa e Luganos, Konventa e Hagës për Zgjedhjen e Juridiksionit me Marrëveshje e 30 qershorit 2005, dhe çdo marrëveshje dypalëshe për këtë qëllim¹⁴ (*si rasti i vendimeve shqiptare*), do të njihet në Austri në bazë të Kodit Austriak të Procedurës Civile, Aktit të Juridiksionit Austriak dhe Aktit Austriak të Ekzekutimit. Praktika gjyqësore austriake nuk është detyruese, por merret në konsideratë nga gjykatat.¹⁵

Kërkesat për deklarimin e njohjes dhe ekzekutimit të një vendimi të huaj në Austri, janë parashikuar në nenin 79 të Aktit Austriak të Ekzekutimit dhe janë si më poshtë:

- Vendimi i huaj është i ekzekutueshëm në vendin ku është dhënë; dhe
- **Reciprociteti sigurohet ndërmjet vendit të origjinës dhe Austrisë ose me marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ose rregullore të tjera (p.sh. rregulloret për reciprocitetin).**

Edhe nëse plotësohen këto kërkesa të detyrueshme për ekzekutueshmëri, deklarimi i ekzekutueshmërisë mund të refuzohet sipas ligjit austriak nëse:

- në përputhje me rregullat austriake mbi juridiksionin, gjykata e huaj nuk do të kishte juridiksion mbi çështjen juridike;
- pala kundërshtarë nuk ka mundur të marrë pjesë siç duhet në procedurën e huaj për shkak të parregullsive në procedurë; ose
- në rast të shkeljes së rendit publik austriak.

Siç shihet, në rastin e Austrisë, ndryshe nga Gjermania, nocioni juridik i reciprocitetit duhet të përcaktohet ose në një marrëveshje ndërkombëtare ose në një rregullore.¹⁶ Përcaktimi i

¹³ Markus Langen, Dr. Andreas Klein & Dominik Stier, Procesi gjyqësor: Ekzekutimi i vendimeve të huaja në Gjermani, 2 korrik 2018, <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=f476bc5a-60f4-4f1a-9aad-22a5e11fb708>

¹⁴ Austria ka marrëveshje bilaterale me Izraelin, Lihtenshteinin, Tunizinë dhe Turqinë. Shiko: Knoeltz, Enforcement of Judgments, Austria, 2023 <https://practiceguides.chambers.com/practice-guides/comparison/730/11433/18397-18399-18407-18414>.

¹⁵ Katharina Kitzberger & Stefan Weber, Enforcement of Judgments Austria, 2022, f. 5 shih: <https://gettingthedealthrough.com/area/46/jurisdiction/25/enforcement-foreign-judgments-austria/>

¹⁶ Julian Feichtinger & Karin Lehner, "Comparative Study of 'Residual Jurisdiction' in Civil and Commercial Disputes in the EU: National Reporter for Austria", (European Commission, 2007), f. 20, <<http://ec.europa.eu/civiljustice/news/docs/studyjresidjurisd-austriaen.pdf>>.

shprehur i reciprocitetit në një marrëveshje ndërkombëtare dhe/ose në një rregullore austriake është një kërkesë e domosdoshme. Pavarësisht nga sa më sipër, edhe nëse reciprociteti sigurohet nga një nga marrëveshjet ose rregulloret e sipërpërmendura, deklarimi i ekzekutueshmërisë mund të refuzohet nëse konstatohet se reciprociteti nuk praktikohet nga vendi i origjinës.¹⁷ Shqipëria nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me Austrinë në lidhje me njohjen ose zbatimin e vendimeve të huaja civile dhe tregtare, dhe për këtë arsye, **vendimet shqiptare nuk mund të njihen dhe/ose të zbatohen në Austri.**

Për sa i përket juridiksionit, sipas nenit 409 të Aktit Austriak të Ekzekutimit, gjykata austriake ka juridiksioni për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të huaj kur selia ose vendbanimi i debitorit është në Austri, dhe si alternativë, *(kur kreditori preferon të kombinojë kërkesën e tij për leje për ekzekutim me kërkesë për autorizim ekzekutimi)* gjykata e rrethit në juridiksionin territorial të së cilës ndodhen pasuritë për qëllime ekzekutimi.

3.3 Mundësia e Njohjes dhe/ose Ekzekutimit të Vendimeve Civile dhe Tregtare Shqiptare në Itali

Një vendim civil ose tregtar i lëshuar nga një gjykatë shqiptare (si dhe nga çdo gjykatë e një shteti në të cilin nuk aplikohet Rregullorja BE 1215/2012, Konventa e Luganos, Konventa e Hagës për Zgjedhjen e Juridiksionit me Marrëveshje e 30 qershorit 2005, dhe çdo marrëveshje dypalëshe për këtë qëllim¹⁸) do të zbatohet në Itali në përputhje me parashikimet e Ligjit për

¹⁷ Katharina Kitzberger & Stefan Weber, Enforcement of Judgments Austria, 2022, f. 6 shiko: <https://gettingthedealthrough.com/area/46/jurisdiction/25/enforcement-foreign-judgments-austria/>

¹⁸ Marrëveshja për ndihmën e ndërsjellë juridike dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile ndërmjet Republikës së Italisë dhe Republikës së Argjentinës, nënshkruar në Romë më 9 dhjetor 1987 (Ratifikuar me Ligjin Nr. 532, 22 Nëntor 1988); Marrëveshja midis Italisë dhe Brazilit për ndihmën e ndërsjellë juridike dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile, i 17 tetorit 1989 Ratifikuar me Ligjin Nr. 336, 18 Gusht 1993; Marrëveshja Itali-Kinë për ndihmën juridike në çështjet civile, i 20 majit 1991 (Ratifikuar me Ligjin Nr. 199, 4 Mars 1994); Marrëveshja Itali-Egjypt për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare dhe për statusin e personave fizikë, e 3 dhjetorit 1977 (Ratifikuar me Ligjin Nr. 619, 9 Maj 1977); Marrëveshja Itali-Liban mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet civile, tregtare dhe penale, ekzekutimin e dënimeve dhe vendimet e arbitrazhit dhe ekstradimin, e 10 korrikut 1970 Ratifikuar me Ligjin Nr.87. 12 Shkurt 1974); Marrëveshja Itali-Marok e 12 shkurtit 1971 lidhur me ndihmën e ndërsjellë, ekzekutimin e dënimeve dhe ekstradimin (Ratifikuar me Ligjin Nr.1043, 12 Dhjetor 1973); Marrëveshja Itali-Tunizi për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet civile, tregtare dhe penale, njohjen dhe ekzekutimin e dënimeve dhe vendimeve dhe ekstradimin, e 15 nëntorit 1967 (Ratifikuar me Ligjin Nr. 267, 28 Janar 1971); Marrëveshja Itali-Kuvajt për bashkëpunimin gjyqësor, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile, e 11 dhjetorit 2002 (Ratifikuar me Ligjin Nr.209, 28 Korrik 2004); Marrëveshja Itali-Moldavi për ndihmën e ndërsjellë, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile, e 7 dhjetorit 2006 (Ratifikuar me Ligjin Nr.174, 12 Nëntor 2009); Marrëveshja Itali-Rusi për ndihmën e ndërsjellë në çështjet civile, e 25 janarit 1979 (Ratifikuar me Ligjin Nr.766, 11 Dhjetor 1985).

të Drejtën Ndërkombëtare Private Italiane (*Ligji Nr. 218 I datës 31 Maj 1995*), i cili është në fuqi që prej vitit 1996. Sipas këtij ligji (n. 64-67) një vendim i huaj mund të ekzekutohet në Itali automatikisht pa qenë nevoja e një procedure paraprake njohje, përveç kur pala ndaj së cilës drejtohet vendimi kundërshton ekzekutimin e vendimit. Në mënyrë që një vendim të jetë i ekzekutueshëm në Itali, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme të parashikuara shprehimisht në nenin 64 të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private Italiane:

- a) Gjyqtari që ka dhënë vendimin ka pasur juridiksion për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me parimet e sistemit ligjor italian;
- b) Akti për njoftimin e fillimit të gjykimit i është njoftuar të paditurit në përputhje me parashikimet e ligjit të vendit ku është zhvilluar procesi gjyqësor dhe nuk janë shkelur të drejtat themelore për t'u mbrojtur;
- c) Palët janë paraqitur përpara gjykatës në përputhje me ligjin e vendit ku është zhvilluar procesi gjyqësor ose gjykimi në mungesë është bërë në përputhje me ligjin;
- d) Vendimi i huaj është bërë përfundimtar dhe i ekzekutueshëm sipas ligjit të vendit në të cilin është dhënë ai vendim;
- e) Vendimi i huaj nuk bie në kundërshtim me një vendim përfundimtar të ndonjë gjykate italiane;
- f) Nuk është duke u zhvilluar përpara një gjykate italiane një proces me të njëjtat palë, të njëjtin shkak padie dhe të njëjtin objekt mosmarrëveshjeje, i cili të ketë filluar para fillimit të procesit gjyqësor para gjykatës së huaj;
- g) Vendimi nuk i huaj nuk është në kundërshtim me rendin publik italian.

Në Nenin 65, Ligji 218/1995 ka parashikuar edhe mundësinë e njohjes dhe ekzekutimit në Itali të atyre akteve të cilat nuk janë vendime gjyqësore por që *inter alia* mund të prodhojnë pasoja në drejtim të zotësisë së personave, ekzistencës së marrëdhënieve familjare ose të të drejtave të personalitetit, kur ato janë dhënë nga autoritetet e shtetit të cilat mund të njihen sipas rregullave të Ligjit 218/1995 ose që mund prodhojnë efekte brenda sistemit ligjor të atij shteti, edhe nëse janë shpallur nga autoritetet e një shteti tjetër. Në këtë rast ato nuk duhet të jenë kundër rendit publik dhe duhet që të jenë respektuar të drejtat themelore në lidhje me mbrojtjen.

Megjithëse Shqipëria nuk ka ndonjë marrëveshje bilaterale me Italinë, falë dispozitave të legjislacionit të brendshëm mbi njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja, të cilat nuk e parashikojnë kushtin e reciprocitetit, ndryshe nga Gjermania dhe Austria, njohja e vendimeve të gjykatave shqiptare në Itali duket se është plotësisht e mundur.

3.4 Mundësia e Njohjes dhe/ose Ekzekutimit të Vendimeve Civile dhe Tregtare Shqiptare në Greqi

Legjislacioni i brendshëm që rregullon njohjen e vendimeve të huaja në Greqi (të lëshuara nga vende jashtë BE-së) është Kodi i Procedurës Civile greke, i cili parashikon një sistem të thjeshtë dhe fleksibël, me një bazë të ngjashme me atë të Rregullores 44/2001 të Brukselit, si edhe disa marrëveshje bilaterale të nënshkruara nga Republika e Greqisë. Një marrëveshje e tillë është edhe Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për Ndhimën

Gjyqësore në Çështjet Civile dhe Penale, nënshkruar më 17.5.1993 dhe ratifikuar me ligjin Nr.2313/1995. Nenet 23 dhe 24 të saj parashikojnë kriteret që duhet të plotësojnë vendimet shqiptare për njohjen dhe ekzekutimin e tyre në Greqi. Ndërsa neni 26 i saj parashikon dokumentet e nevojshme që duhet t'i bashkëngjiten kërkesës për të ndjekur procedurën e njohjes.

Kodi Procedurës Civile (nenet 905 (2) (3), 323, pikat 2 deri në 5) parashikon kushtet që duhet të plotësojë një vendim i huaj për tu njohur në Greqi, që janë: (a) Vendimi duhet të jetë i ekzekutueshëm sipas ligjit të vendit ku është lëshuar; (b) Gjykata e shtetit të origjinës së vendimit të ketë pasur juridiksionin në përputhje me ligjin grek; (c) Palës kundër së cilës i drejtohet vendimi nuk duhet t'i jetë mohuar e drejta e mbrojtjes ose e drejta e pjesëmarrjes në proces; (e) vendimi i huaj nuk duhet të bjerë ndesh me rendin publik.

IV. SAGA E NJOHJES SË NJË VENDIMI TREGTAR SHQIPTAR NË DISA SHTETE TË EVROPËS

Në vitin 2009 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dhënë një vendim në lidhje me çështjen *AlbaniaBEG Ambient Sh.p.k kundër Enel SpA*. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2010 dhe në vitin 2011 Gjykata e Lartë e Shqipërisë nuk ka pranuar rekursin e palës gjyq humbëse që në rastin konkret ishte Enel spa. Në këto kushte, vendimi i dhënë në favor të shoqërisë AlbaniaBEG Ambient Sh.p.k (referuar më poshtë ABA) ka fituar statusin *res judicata* në Shqipëri. ABA ka kërkuar njohjen e këtij vendimi në të paktën pesë shtete: Nju Jork në Shtetet e Bashkuara, Holandë, Francë, Irlandë dhe Luksemburg. Në këto pesë shtete, ABA është përballur me pesë kuadra ligjorë të ndryshëm në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të huaj dhe për të njëjtin vendim janë bërë pesë arsyetime të ndryshme ligjore në lidhje me njohjen ose mosnjohjen e tij. Kjo praktikë gjyqësore vjen si shembull i mospërputhshmërisë dhe paparashikueshmërisë që shkakton mungesa e multilateralizmit në njohjen e vendimeve të huaja.

4.1 Njohja e Vendimit Gjyqësor Shqiptar në Çështjen *ABA Kundër Enel Spa* në Nju Jork, SHBA

ABA kërkoi njohjen e vendimit shqiptar në Gjykatën e Apelit të Nju Jork-ut dhe Enel spa (pala gjyq humbëse) kërkoi refuzimin e njohjes së vendimit gjyqësor shqiptar me arsyetimin se sipas nenit 53 të Ligjit dhe Rregullave të Praktikës Civile, gjykata e shtetit të Nju Jork-ut nuk kishte as juridiksion *personal* dhe as *in rem* për të shqyrtuar kërkesën për njohjen e vendimit gjyqësor shqiptar. Në mënyrë alternative, nëse gjykata do të pranonte që kishte juridiksion, Enel spa pretendoi refuzimin e njohjes, duke argumentuar, ndër të tjera, se vendimi shqiptar bie ndesh me një vendim të mëparshëm përfundimtar të gjykatave italiane, procesi në gjykatën shqiptare ishte në kundërshtim me një marrëveshje midis palëve për të gjykuar mosmarrëveshjet e tyre me arbitrazh në Itali, Shqipëria nuk ofronte gjykata të paanshme ose procedura të pajtueshme me procesin e rregullt ligjor, vendimi shqiptar, i cili parashtron një formulë për të përcaktuar pjesën më të madhe të shumës që do të kompensohej, nuk është

bërë për kompensimin e gjithë shumës së parave, duke e bërë atë jo përfundimtar.¹⁹ Gjykata amerikane nuk gjeti ndonjë provë që tregonte ndonjë lidhje të të dyja kompanive me Qarkun e Nju Jorkut, dhe për rrjedhojë arriti në përfundimin se Gjykata e Apelit të Nju Jork-ut nuk ka juridiksion për të shqyrtuar njohjen e vendimit gjyqësor shqiptar.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, ABA ushtroi të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë të Qarkut të Nju Jork-ut, duke argumentuar se, Gjykatës së Nju Jorkut nuk i mungon juridiksioni për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit shqiptar dhe për këtë bazohej në vendimin e Gjykatës së Nju Jork-ut në vendimin Abu Dhabi të vitit 2014.²⁰ Ky vendim i fundit kishte përcaktuar se sipas nenit 53 të Ligjit dhe Rregullave të Praktikës Civile asnjë lloj juridiksioni, qoftë *personal* apo *in rem*, nuk kërkohet si kusht për të kërkuar njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të huaj në Nju Jork.

Në datën 8 shkurt 2018, Gjykata e Lartë e Qarkut të Nju Jorkut la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit të Nju Jorkut me të njëjtin arsyetim, për mungesë juridiksioni. Gjykata hodhi poshtë gjithashtu argumentin e ABA-s, duke arsyetuar, ndër të tjera, se:²¹

“...Abu Dhabi nuk duhet lexuar kaq gjerësisht.

...

Vendimi i Abu Dhabit zbatohet vetëm “në rrethanat” (id.) që u paraqitën në atë çështje, domethënë, kur i padituri - ndryshe nga të paditurit në çështjen para nesh - nuk pretendon se ekzistojnë arsye thelbësore për të refuzuar njohjen e vendimit të huaj sipas nenit 53. Premisa themelore e përcaktimit në Abu Dhabi se Gjykata e Lartë në atë çështje kishte vendosur në favor të njohjes sipas nenit 53, pavarësisht mungesës së juridiksionit personal ose in rem, ishte se gjykata thjesht kishte “kryer një funksion ministror” (id. në 613) duke lejuar njohjen një vendimi të huaj, forma e prerë dhe vlefshmëria e të cilit ishte e padiskutueshme sipas standardeve të nenit 53. Kështu, në çështjen Abu Dhabi, pranimi çështjes për njohje dhe ekzekutim në Nju Jork nuk krijoi “vështirësi” për të paditurin, pasi “nuk [kishte] asgjë për të mbrojtur” (id.), duke qenë se i padituri nuk ngrinte asnjë arsye thelbësore për refuzimin e njohjes së vendimit anglez. [FN 15]

*Abu Dhabi, sipas kushteve të veta, nuk mund të rregullojë rastet ku - siç është rasti këtu - e drejta e vendimit të huaj [*11] për tu njohur sipas nenit 53 vibet në pikëpyetje. Në këtë situatë, ka diçka për të mbrojtur dhe funksioni i gjykatës pushon së qeni thjesht ministror. Në një rast të tillë - dhe çështja*

¹⁹*AlbaniaBEG Ambient Sh.p.k v Enel SpA* 2018 NY Slip Op 00928, datë 8 Shkurt 2018, <https://law.justia.com/cases/new-york/appellate-division-first-department/2018/152679-14-3306.html>

²⁰ Në çështjen e Abu Dhabit, paditësi, një bankë me seli në Emiratet e Bashkuara Arabe, kërkoi të zbatonte një vendim të Gjykatës së Lartë Angleze të Drejtësisë kundër të paditurit, një shoqëri komandite me vendbanim në Arabinë Saudite, sipas nenit 53 të CPLR. Duke kundërshtuar kërkesën e paditësit, I padituri argumentoi rrëzimin e kërkesës për njohje vendimi me arsyetimin se, gjykata e Nju Jorkut nuk kishte juridiksion as *personal* dhe as *in rem*. I padituri në çështjen e Abu Dhabit nuk ngriti asnjë nga shkaqet e tjera ligjore për mosnjohjen e një vendimi të një vendi të huaj të përcaktuar në CPLR 5304. Në këtë kontekst të veçantë, ku i padituri, që kundërshtonte njohjen e vendimit të huaj, nuk pretendoi asnjë nga mbrojtjet statutorë për një njohje të tillë, gjykata arriti në përfundimin se vendimi i huaj mund të njihet edhe nëse gjykata nuk kishte juridiksion *personal* ose *in rem*.

²¹*AlbaniaBEG Ambient Sh.p.k v Enel SpA* 2018 NY Slip Op 00928, datë 8 Shkurt 2018, <https://law.justia.com/cases/new-york/appellate-division-first-department/2018/152679-14-3306.html>

para nesh është një rast i tillë – gjykatës i kërkohet të shqyrtojë në themel çështjet e kontestuara të faktit, të ligjit ose të të dyjave dhe, nëse ngrihen shkaqe jo të detyrueshme për mosnjohjen e një vendimi, të ushtrrojë drejtësi. Të kërkosh nga një i paditur të ngrejë çështje të tilla thelbësore në një forum ku ai nuk mban asnjë pasuri dhe ku nuk ka kontakte që përndryshe do t'i nënshtrobeshin juridiksionit personal, do të “fyente [nacionet] tradicionale të lojës së ndershme dhe drejtësisë substanciale”

Prandaj, për shkak se ABA nuk ka mundur të provojë as juridiksionin personal dhe as in rem për zhvillimin e këtij procesi në Nju Jork dhe nuk na kërkon një mundësi për të kërkuar ndonjë provë në këtë drejtim, ne konkludojmë se kërkesa e të paditurit për refuzim njohje dubet të pranohet...”

Sipas mendimit të disa juristëve, pas këtij vendimi të Gjykatës së Lartë të Nju Jorkut të datës 8 shkurt 2018, njohja e vendimeve të shteteve të huaja në shtetin e Nju Jork-ut është bërë më e vështirë.²² Gjithsesi, nuk duket se vendimi në çështjen *ABA vs Enel* të ketë pasur ndikim në çështjen *Diaz kundër Galopy Corp. Intl.*,²³ të dhënë vetëm tre muaj më vonë. Në maj të vitit 2018, një gjykatë e Nju Jork-ut shqyrtoi një çështje ku një palë e interesuar kërkoi njohjen e një vendimi gjyqësor venezuelas. Debitori (*pala gjyq humbëse*) nuk parashtrroi asnjë arsye thelbësore për mosnjohjen e vendimit, por kërkoi pushimin e çështjes me arsyetimin se debitori nuk kishte lidhje të mjaftueshme me shtetin e Nju Jork-ut, dhe për rrjedhojë gjykata nuk kishte juridiksion. Duke cituar çështjen e Enel-it, gjykata e Nju Jork-ut pranoi njohjen e vendimit venezuelas duke vënë në dukje “se juridiksioni *personal* apo *in rem* i gjykatës është i nevojshëm për shqyrtimin e një kërkesë për njohje vendimi gjyqësor të huaj vetëm kur debitori (*pala gjyq humbëse*) parashtron arsye thelbësore (shkaqe refuzimi në lidhje me vendimin)”. Për shkak se në çështjen konkrete pala debitore nuk ngriti shkaqe për refuzimin e njohjes së vendimit, vendimi gjyqësor venezuelas u njoh nga gjykata e Nju Jork-ut.²⁴

4.2 Njohja e Vendimit Gjyqësor Shqiptar në Çështjen *ABA kundër Enel Spa* në Irlandë

Më 13 shtator 2018, Gjykata e Apelit në Irlandë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Lartë Tregtare në çështjen *Albaniabeg Ambient Shpk kundër Enel SpA dhe Enelpower SpA*²⁵ me argumentin se gjykata irlandeze nuk ka juridiksion të shqyrtojë kërkesën për njohje vendimi të

²² New York Appellate Court Imposes Jurisdictional Requirements in Foreign Judgment Recognition Actions, 18 mars 2018,

http://www.lbkmlaw.com/media/event/134_Neë%20York%20Appellate%20Court%20Imposes%20Jurisdictional%20Requirements.pdf

²³ Diaz v Galopy Corp. Intl., NV, 61 Misc. 3d 429 (Sup. Ct. NY Co. 2018) <https://caselaw.findlaw.com/court/ny-supreme-court/1897716.html>

²⁴ M. Zachary Bluestone, Gabriel Bluestone. “Enforcing foreign judgments in New York: Are NY Courts still favorable to foreign judgment holders? Asset Recovery Magazine, Issue 2 - The International Edition, 24 April 2019, f. 10, https://informaconnect.com/article/pdfs/ef13865a-23d5-4b4d-ba44-d701032546db_AssetRecoveryMagazine-April2019-Issue2v.pdf

²⁵ *Albaniabeg Ambient Shpk -v- Enel SpA & Anor*, [2016] IEHC 139, datë 08.03.2016, <https://www.bailii.org/ie/cases/IEHC/2016/H139.html>, para. 43.

huaj, nëse nuk arrin të provojë se pala kërkuese e njohjes ka përfitime konkrete nga njohja në këtë shtet.²⁶

Shkaqet e refuzimit të njohjes dhe ekzekutimit të një vendimi të huaj të dhënë në një shtet jashtë BE-së në Irlandë janë më të gjera sesa ato të Rregullores së Brukselit (BE) Nr. 1215/2012 dhe Konventës së Lugano-s. Dispozitat e aplikueshme në një rast të tillë janë ato të parashikuara në Urdhrin 11 dhe parimet standarde të *common law*. Për të zbatuar një vendim të huaj sipas Urdhrit 11, kërkuesi i njohjes së vendimit të huaj duhet të provojë se: (1) ka një çështje *prima facie* të bazuar; (ii) do të ketë përfitime konkrete nga njohja e vendimit në Irlandë; dhe (iii) plotëson kërkesat krahasuese të kostos dhe komoditetit të Urdhrit 11, Rregulli 2.²⁷

Sipas vendimit të gjykatës irlandeze në çështjen konkrete, vendimi gjyqësor shqiptar nuk plotësonte kriterin e dytë, “përfitimin konkret nga njohja”. Për të dalë në këtë përfundim, gjykata analizoi dy pyetje; *së pari*, a duhet që pala debitore të ketë asete brenda juridiksionit të gjykatave irlandeze?; *së dyti*, a është njohja e vendimit nga një gjykatë neutrale, e respektuar ndërkombëtarisht, përfitim i mjaftueshëm praktik për kërkuenin e njohjes së vendimit? Në përfundim të analizës, gjykata irlandeze arriti në përfundimin se, kërkuesi i njohjes së vendimit nuk mundi të provojë se kishte ndonjë përfitim konkret dhe praktik nëse vendimi do të njihet në Irlandë. Megjithatë të pasurit e aseteve brenda juridiksionit nuk është një parakusht për njohje në Irlandë, mungesa e aseteve ka të ngjarë të jetë e mjaftueshme për të konstatuar se nuk ka “përfitim të fortë praktik”.

4.3 Njohja e Vendimit Gjyqësor Shqiptar në Çështjen *ABA Kundër Enel Spa* në Holandë

Me vendimin e datës 29 qershor 2016, Gjykata e Qarkut të Amsterdemit njohu vendimin gjyqësor shqiptar në Holandë. Enel spa ushtroi të drejtën e ankimit kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut të Amsterdemit. Më 17 korrik 2018, Gjykata e Apelit të Amsterdemit vendosi se vendimi i gjykatës shqiptare ishte në thelb arbitrar dhe haptazi i paarsyeshëm dhe për rrjedhojë nuk mund të njihet në Holandë, pasi kjo do të cenonte rendin publik holandez.

Sipas arsyetimit të Gjykatës së Apelit të Amsterdemit:

“vendimi gjyqësor shqiptar duhet të konsiderohet si arbitrar dhe haptazi i paarsyeshëm dhe se procesi ligjor shqiptar nuk është në përputhje me kërkesat që do të vendosen për këtë në bazën e nenit 6 të KEDNJ. Kjo do të thotë se vendimi gjyqësor shqiptar nuk është marrë nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor që plotëson kërkesat e një drejtësie adekuate. Njohja e vendimit gjyqësor shqiptar në Holandë

²⁶Albaniabeg Ambient Sh.pk -v- Enel SpA & Enelpower SpA; [2018] IECA 46, datë 26/02/2018, Vendim i Gjykatës Irlandeze të Apelit. Shihni në: <https://www.bailii.org/ie/cases/IECA/2018/CA46.html>

²⁷Julie Murphy-O'Connor & Gearoid Carey, “Enforcement of Foreign Judgments in Ireland: Irish Court of Appeal Declines Jurisdiction to Recognize and Enforce a Non-EU/EFTA Judgment where no Apparent Practical Benefit would Accrue to the Appellant”, International Corporate Rescue (2018), f. 271, pika 2.1 Shih: https://www.matheson.com/docs/default-source/practice-area-attachments/corporate-restructuring-and-insolvency/enforcement-of-foreign-judgments-in-ireland-irish-court-of-appeal-update.pdf?sfvrsn=f7f82d9a_2

do të nënkuptonte që Enel et al. t'i kërkohet në Holandë të respektojë një vendim gjyqësor arbitrar, dukshëm të pasaktë dhe të paarsyeshëm, i cili është në kundërshtim me vlerat dhe parimet themelore të rendit juridik holandez. Kjo do të thotë se njohja e vendimit që është dhënë në mënyrën e sipërpërmendur, në kuptimin që i atribuohet plotësisht ose pjesërisht efekteve juridike në Holandë, është në kundërshtim me rendin publik, si për sa i përket aspektit procedural (para. 3.22. under ii) dhe për sa i përket aspektit material (para. 3.22. point (iii)). Për shkak të shkeljes së rendit publik në Holandë, vendimi gjyqësor shqiptar nuk mund të njihet në bazë të nenit 431 (2) të KPC.”²⁸

4.4 Njohja e vendimit gjyqësor shqiptar në çështjen ABA kundër Enel SpA në Francë

Më 29 janar 2018, Gjykata e Shkallës së Parë në Paris, refuzoi njohjen e vendimit gjyqësor shqiptar në Francë për mungesë të plotësimit të kërkesave të ligjit francez për qëllime të ekzekutimit të një vendimi të huaj, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: (i) vendimi gjyqësor shqiptar bie ndesh me një vendim ekzistues, në këtë rast vendimin e arbitrazhit të vitit 2002 dhe se (ii) fakti që ABA kërkoi të merrte në Shqipëri atë që nuk ishte në gjendje për të marrë në procesin e arbitrazhit italian, duke riparuarit të njëjtin pretendim, përfaqësonte një mashtrim. ABA ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. ABA e apeloj vendimin, i cili u la në fuqi nga Gjykata e Apelit të Parisit më 2020. Në bazë 137 të rekursit të ABA-s, me vendimin e datës 17 maj 2023, Gjykata e Lartë franceze refuzoi njohjen në Francë të vendimit shqiptar po me arsyetimin se ai ishte kërkuar me qëllim shmangien e një vendimi arbitrazhi të marrë më parë në Itali, gjë që përbën mashtrim dhe bie ndesh me rendin publik.²⁹

V. REGJIMI AKTUAL I NJOHJES DHE/OSE EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE TË HUAJA CIVILE DHE TREGTARE NË SHQIPËRI

Kodi Shqiptar i Procedurës Civile parashikon që, në mungesë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. (n. 393 KPC)) Siç u përmend më lart, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Hagës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja në Çështjet Civile dhe Tregtare të datës 1 shkurt 1971, por nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje plotësuese me asnjë nga shtetet kontraktuese të kësaj Konvente. Prandaj, kjo Konventë nuk është e zbatueshme.

Shqipëria ka nënshkruar gjithashtu marrëveshje dypalëshe në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja civile dhe tregtare me Bullgarinë, Maqedoninë, Turqinë, Greqinë, Rusinë, Rumaninë dhe Hungarinë. Këto marrëveshje dypalëshe janë në fuqi, por dispozitat e tyre janë shumë të vjetruara në disa aspekte. Bazuar në një hulumtim të kryer në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Durrës, edhe kur një marrëveshje e tillë ka qenë e mundur të zbatohet, kërkesat e palëve të interesuara për njohjen e një vendimi të huaj nuk janë bazuar në dispozitat e këtyre

²⁸ Vendim i Gjykatës së Apelit të Amsterdemit, date 17.07.2018, në çështjen me nr. 200.196.175/01, para. 3.33; Shiko: <https://uitspraken.rechtspraak.nl/inziendocument?id=ECLI:NL:GHAMS:2018:3008>;

²⁹ Vendim i Gjykatës franceze të Kasacionit datë 17.05.2023, <https://www.courdecassation.fr/decision/6464c680bfe1af822a1dfd71>

marrëveshjeve, por në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile³⁰ dhe shumë rrallë në të dyja.³¹ Në këto të fundit, gjykatat shqiptare nuk kanë marrë në konsideratë (analizuar) dispozitat e Marrëveshjes konkrete, dhe arsyetimi i gjykatës është bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.³²

Sipas Kodit të Procedurës Civile, një vendim i huaj mund të ekzekutohet në Shqipëri vetëm pasi të njihet me vendim të Gjykatës së Apelit (*n. 395 KPC*), e cila nuk vendos për themelin e çështjes (*n. 397 KPC*), por verifikon vetëm ekzistencën e shkaqeve të refuzimit të parashikuara shprehimisht në nenin 394 të KPC-së.

KPC-ja nuk parashikon shprehimisht asnjë faktor lidhës për të përcaktuar kompetencën e gjykatës mbi kërkesat për njohjen e vendimeve të huaja. Neni 395 i KPC-së parashikon se: “Kërkesa për njohjen e një vendimi të huaj duhet të paraqitet në Gjykatën e Apelit...” Në kohën kur në Shqipëri kishte disa gjykata apeli, dispozita e cila nuk parashikon shprehimisht se në cilën gjykatë apeli, interpretohej në lidhje me nenin 49 të KPC-së, dhe qëndrimi ishte se gjykata kompetente është gjykata e apelit e vendit ku synohet të ekzekutohet vendimi.³³ Dhe praktika gjyqësore shqiptare ka ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi.³⁴ Aktualisht, me hartën e re gjyqësore ka vetëm një gjykatë apeli, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila është kompetente për shqyrtimin e kërkesave për njohjen e vendimit të gjykatave të huaja.

Sipas nenit 394 të KPC-së, një vendim i huaj civil ose tregtar nuk mund të njihet në Shqipëri kur:

- a. Sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në juridiksionin e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin;
- b. Kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t’i dhënë atij mundësi që të mbrohet;
- c. Midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;
- ç **Është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë;**
- d. I është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij;
- e. Nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Vëmë në dukje se, dispozita e nenit 394(ç) paraqitet problematike, sepse mund të keqpërdoret për të vështirësuar njohjen e një vendimi të huaj në Shqipëri. Një palë e interesuar që ka humbur çështjen në një gjykatë të një vendi të huaj, mundet, përpara se vendimi të marrë formë të prerë në vendin e huaj, të fillojë një proces gjyqësor në një gjykatë shqiptare me të njëjtin shkak padie (*causa petendi*), të njëjtin objekt (*petitium*) dhe të njëjtat palë. Nëse do të kishim një situatë të tillë, sipas nenit 394 (ç) të KPC-së, gjykata do të duhej të refuzonte njohjen e

³⁰ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr. 288/15 Regj. nr 7, datë 28.01.2019.

³¹ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr. 218/2 Regj. Nr.10, datë 24.01.2018.

³² *Idem*

³³ Flutura Kola Tafaj, Asim Vokshi “Procedura civile”, Pjesa II, Botim II, (2018), f. 154, para. 4.

³⁴ Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 205, Regj. nr 180, datë 12.12.2017.

vendimit të huaj. Ky parashikim, më shumë se i qëllimshëm, duket si një transpozim i paplotë i parashikimeve të ligjit procedural italian për të njëjtën çështje. Norma analoge në KPC-në italian parashikon si shkak, faktin “...që përpara një gjykate italiane është duke u zhvilluar një proces me të njëjtat palë, të njëjtin shkak padie dhe të njëjtin objekt mosmarrëveshjeje, i cili ka filluar para fillimit të procesit gjyqësor para gjykatës së huaj”. Pra, ligji Italian, situatën analoge e lidh me fillimin e procesit në gjykatën e Italisë në krahasim me fillimin e procesit në gjykatën e shtetit të huaj dhe jo me marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës së shtetit të huaj.

Me ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Civile me ligjin 37/2018, ky rrezik mund të shmanget. Sipas nenit të ri 38 paragrafi 1 i KPC-së: “1. Kur e njëjta padi, midis të njëjtave palë, me të njëjtin shkak dhe objekt padie, është duke u shqyrtuar njëkohësisht nga një gjykatë e shtetit të huaj dhe gjykata shqiptare, kjo e fundit mund të pezullojë gjykimin e kësaj mosmarrëveshjeje kur:

- a) *Padia është paraqitur më parë në kohë në gjykatën e shtetit të huaj;*
- b) *Vendimi i gjykatës së shtetit të huaj është i mundshëm për t'u njohur dhe/ose ekzekutuar në Republikën e Shqipërisë;*
- c) *Gjykata shqiptare bindet se pezullimi është i nevojshëm për administrimin e duhur të drejtësisë.*

Megjithatë, përderisa dispozita e mësipërme parashikon se gjykata “mund” të pezullojë procedurën, ekziston rreziku që edhe gjykata shqiptare të vazhdojë të procedojë, pra të mos e pezullojë gjykimin. Në këtë situatë të fundit, sipas nenit 394 (ç), vendimi i huaj që do të jepet për të njëjtën çështje jashtë shtetit, nuk mund të njihet në asnjë rast në Shqipëri.

Referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Durrës, njohja e vendimit të huaj civil nuk është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar. Gjykatat shqiptare nuk janë të prirura të bëhen pengesë për njohjen e vendimeve të huaja civile dhe tregtare. Përkundrazi, vihet re, tendenca për të interpretuar në mënyrë shteruese dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.³⁵ Në praktikën gjyqësore shqiptare, vihet re që, arsyet e refuzimit të njohjes lidhen më së shumti me mungesën e njoftimit të të paditurit,³⁶ mos-provueshmëria e faktit se vendimi ka marrë formë të prerë në shtetin e origjinës,³⁷ mungesa e juridiksionit të gjykatës së shtetit të huaj.³⁸

Gjykatat shqiptare nuk zbatojnë parimin e reciprocitetit. Pavarësisht vendit të origjinës së vendimit të huaj, gjykatat shqiptare refuzojnë ose pranojnë të njohin një vendim të huaj pa marrë parasysh reciprocitetin. Për shembull, megjithëse gjykatat austriake nuk i njohin vendimet shqiptare, gjykatat shqiptare mund t'i njohin lirisht vendimet austriake nëse ato plotësojnë kërkesat e nenit 394 deri në 396 të KPC-së.

³⁵Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr. 60, datë 07.06.2011; Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr. 218/2, nr 10, datë 24.01.2018; Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr 207/9 Regj; nr 40, datë 23.02.2017; Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr. 18 Regj. nr 18, datë 28.02.2008.

³⁶ Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr. 288/15 Regj. nr 7, datë 28.01.2019.

³⁷*Idem*

³⁸Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr.30-2018-4659, datë 27.07.2018.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendim të datës 23.02.2017,³⁹ ka zgjeruar fushën e zbatimit të dispozitave për njohjen e vendimeve të huaja, duke përfshirë në konceptin e “vendimit” edhe urdhrat e gjykatave të shteteve të tjera. Gjykata e Apelit Tiranë ka bërë një interpretim të zgjeruar dhe në përputhje me Rregulloren e Brukselit 2012/2015 të konceptit “vendim” duke arsyetuar se: “Është e vërtetë që Kodi i Procedurës Civile Shqiptare nuk parashikon shprehimisht procedurën e njohjes së një urdhri për pagesë, siç ndodh në shumë vende evropiane dhe siç parashikohet të përfshihet në Kodin tonë, si masë gjykimi efektiv, por vendimi që ka rezultuar në përfundim të kësaj procedure ka karakterin e një vendimi gjyqësor në lidhje me detyrimin e debitorit për të kryer pagesën sipas detyrimit kontraktor.”

VI. REGJIMI I PRITSHËM I NJOHJES DHE/OSE EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE CIVILE DHE TREGTARE PAS RATIFIKIMIT TË KONVENTËS SË VENDIMEVE HCCH 2019

Në rast se Shqipëria ratifikon Konventën e Vendimeve HCCH 2019, mes një numri të konsiderueshëm shtetesh, përfitimet do të jenë të konsiderueshme dhe disa nga pritshmëritë kryesore pozitive po i rendisim më poshtë.

6.1 Njohja dhe/ose Ekzekutimi i Vendimeve Gjyqësore Shqiptare në Shtete të Huaja dhe Anasjelltas do të Jetë i Parashikueshëm

Sipas Konventës së Vendimeve HCCH 2019, vendimet shqiptare do të njihen dhe/ose do të ekzekutohen (ose refuzohen të njihen dhe ekzekutohen) në çdo Shtet Kontraktues të Konventës për të njëjtat shkaqe dhe anasjelltas, çdo vendimi i huaj do të mund të njihet ose refuzohet të njihet në Shqipëri për të njëjtat shkaqe si në çdo Shtet Kontraktues të Konventës. Me fjalë të tjera, ratifikimi i kësaj Konvente do të thotë se kuadri ligjor për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore do të jetë i unifikuar dhe për rrjedhojë i parashikueshëm (*nenet 5 dhe 7*).

Unifikimi i kuadrit ligjor për njohjen dhe/ose ekzekutimin e vendimeve të huaja është një garanci pozitive për investitorët e huaj në Shqipëri. Kuadri ligjor është një lloj *laissez-passez* për investitorët apo për këdo që është i interesuar të ketë marrëdhënie ekonomike apo biznesi me Shqipërinë, njëlloj si Konventa e Nju Jorkut për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, sepse palët e interesuara do të kishin që në fillim pritshmëritë në çdo rast të mundshëm të nevojës për ekzekutim vendimi në të ardhmen. Edhe palët e interesuara shqiptare, të cilat synojnë të njohin dhe/ose të ekzekutojnë një vendim shqiptar jashtë vendit, do të jenë të vetëdijshëm paraprakisht për shkaqet për njohjen dhe/ose refuzimin e njohjes së vendimit të tyre në çdo gjykatë të shtetit kontraktues të Konventës së Vendimeve HCCH 2019 pa pasur nevojë të analizojnë dispozitat e çdo ligji kombëtar të shtetit ku ata duan të njohin dhe/ose të ekzekutojnë vendimin e tyre.

Konventa e Vendimeve HCCH 2019 nuk parashikon vetëm unifikimin e shkaqeve në lidhje me refuzimin e njohjes, por edhe disa aspekte procedurale të procedurës së njohjes së një

³⁹ Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 40, Regj. Nr 207/9, datë 23.02.2017.

vendimi të huaj. Neni 13.1 i Konventës në fjalë parashikon se procedura e procesit të njohjes dhe/ose ekzekutimit do të rregullohet nga ligji i shtetit në të cilin kërkohet njohja, përveç rasteve kur Konventa parashikon ndryshe. Për sa i përket dokumenteve që duhen paraqitur për procedurën e njohjes, neni 12 parashikon ndryshe, duke renditur dokumentet që duhen paraqitur. Në këtë aspekt, mund të thuhet se edhe lista e dokumenteve që do të shoqërojnë kërkesën për njohje vendimi do të jetë gjithashtu e parashikueshme.

Nëse i kthehemi historisë së njohjes së vendimit shqiptar të sipërpërmendur në pikën III më sipër, në pesë shtete të ndryshme, në rast se Konventa do të kishte qenë e zbatueshme në të gjitha këto shtete, situata do të kishte qenë ndryshe. Rezultati mund të ishte i njëjtë, por pa dyshim që, pala e interesuar do të ishte përballur me shumë më pak të papritura dhe procesi i njohjes do të kishte qenë i parashikueshëm. Në vend që të përballej me pesë korniza të ndryshme ligjore, pala e interesuar do të ishte përballur vetëm me një, me atë të parashikuar nga Konventa e Vendimeve HCCH 2019.

Për më tepër, ratifikimi i Konventës (pa rezerva nga Shqipëria dhe shtete të tjera gjithashtu) shmang kërkesën e reciprocitetit (qoftë *de facto*, ose *de jure*) për njohjen dhe/ose ekzekutimin e vendimeve, e cila është e zbatueshëm në disa shtete. Në këtë rast, vendimet shqiptare do të mund të njihen dhe/ose të ekzekutohen lirisht në Austri (që aktualisht kërkon një reciprocitet *de jure* dhe *de facto*), Gjermani (që kërkon reciprocitet *de facto*) etj.

Së fundi, një kornizë e parashikueshme për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve do t'i mundësojë palës të bëjë një zgjedhje më të informuar se ku do të nisë procedurat e saj fillestare. Nëse një palë ka mundësinë të zgjedhë juridiksionin gjyqësor të dy shteteve të ndryshme për ngritjen e padisë, dhe vendimi i gjykatave të një shteti do të mund të njihet sipas Konventës, ndërsa vendimi i gjykatave të shtetit tjetër jo, ky është një faktor i rëndësishëm që do t'i drejtojë palët në zgjedhjen më efikase të gjykatës ku do të ngrenë padinë.⁴⁰

6.2 Njohja dhe/ose Ekzekutimi i Vendimeve Shqiptare do të Jetë Konsistente

Unifikimi i kuadrit ligjor për njohjen dhe/ose ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nëpërmjet Konventës së Vendimeve HCCH 2019 do të bëhej një histori suksesi nëse do të pasohej nga një uniformitet në lidhje me interpretimin e dispozitave të saj. Për të nxitur interpretimin e saj në mënyrë uniforme, neni 20 i Konventës parashikon se “Në interpretimin e kësaj Konvente, do të merret parasysh karakteri i saj ndërkombëtar dhe nevoja për të nxitur uniformitetin në zbatimin e saj.” Duhet mbajtur parasysh se konceptet dhe parimet që janë aksiomatike në një sistem juridik mund të jenë të panjohura ose të refuzuara në një tjetër. Objektivat e draft Konventës mund të arrihen vetëm nëse të gjitha gjykatat e zbatojnë atë me mendje të hapur.⁴¹

⁴⁰ David Goddard, “The Judgments Convention – The Current State of Play”, *Duke Journal of Comparative & International Law*, Vol. 29, 2019, f. 477; Shiko:

<https://scholarship.law.duke.edu/cgi/viewcontent.cgi?referer=&httpsredir=1&article=1551&context=djcil>

⁴¹ Francisco Garcimartín & Geneviève Saumier, *Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters. Explanatory Report 2020*, f. 156, para. 352, <https://assets.hcch.net/docs/a1b0b0fc-95b1-4544-935b-b842534a120f.pdf>

Sipas Raportit Shpjegues të Konventës, neni 20 duhet të lexohet së bashku me nenin 21 (Rishikimi i funksionimit të Konventës), sepse të dy nenet kanë objektivin e një zbatimi të drejtë dhe uniform të draft Konventës. Sipas nenit 21 “Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private në intervale të rregullta merr masa për rishikimin e funksionimit të kësaj Konvente, duke përfshirë çdo deklaratë, dhe i raporton Këshillit për Çështjet e Përgjithshme dhe Politikat.”⁴²

6.3 Konventa Njeh Juridiksionin Ekskluziv të Gjykatave të Vendit ku Ndodhet Pasuria e Paluajtshme në Lidhje me të Drejtat *In Rem* mbi Këto Pasuri

Edhe pse sipas të Drejtës Ndërkombëtare Private Shqiptare, nuk ka asnjë ndalim të shprehur për të gjykuar pretendimet për të drejtat reale mbi pasurinë e paluajtshme që nuk ndodhen në Shqipëri, doktrina ka mbështetur qasjen se gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion mbi pretendimet që lidhen me pronat e paluajtshme që ndodhen jashtë territorit të Shqipërisë.⁴³ Konventa e Vendimeve HCCH 2019 jep një arsye shtesë për t’i bërë gjykatat shqiptare të njohin juridiksionin ekskluziv për të drejtat *in rem* mbi pasuritë e paluajtshme të gjykatave të shteteve të tjera. Në të kundërt gjykatat shqiptare do të nxjerrin një vendim të pazbatueshëm në shtetet e tjera, duke shkelur në këtë mënyrë parimin e aksesit në drejtësi, i cili kërkon një drejtësi efektive. Sipas nenit 6 të Konventës së Vendimeve HCCH 2019, një vendim në lidhje me të drejtat reale mbi pasurinë e paluajtshme do të njihet dhe zbatohet nëse dhe vetëm nëse prona ndodhet në shtetin e origjinës së vendimit.

6.4 Ratifikimi i Konventës do të Shmangë Zbatimin e Nenit Problematik 394(ç) të KPC-së

Ratifikimi i Konventës do të shmangë zbatimin e nenit 394(ç) të KPC, i cili parashikon se: “Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë.” Siç e kemi përmendur edhe më lart, kjo dispozitë mund të përdoret në mënyrë abuzive nga çdo palë e interesuar për të vonuar ose pamundësuar njohjen e një vendimi të huaj në Shqipëri. Sipas Konventës së Vendimeve, njohja ose ekzekutimi mund të shtyhet ose refuzohet nëse proceset ndërmjet të njëjtave palë për të njëjtën çështje janë në pritje përpara një gjykate të shtetit të kërkuar kur: (a) gjykata e shtetit në të cilin kërkohet njohja është investuar (vënë në lëvizje) përpara gjykatës së vendit ku është dhënë vendimi; dhe (b) ka një lidhje të ngushtë midis mosmarrëveshjes dhe shtetit në të cilin kërkohet njohja. Një refuzim bazuar në këtë dispozitë, nuk pengon palën e interesuar të paraqesë një kërkesë të mëvonshme për njohjen ose ekzekutimin e këtij vendimi (Neni 7(2)). Sipas Konventës së Vendimeve HCCH 2019, njohja e një vendimi të huaj mund të shtyhet ose refuzohet vetëm nëse gjykatat shqiptare janë investuar në kohë përpara gjykatës së origjinës

⁴² Francisco Garcimartín & Geneviève Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters. Explanatory Report 2020, f. 156-157. <https://assets.hcch.net/docs/a1b0b0fc-95b1-4544-935b-b842534a120f.pdf>

⁴³ Jessel-Holst, Maltezi, Kola Tafaj, Gugu Bushati, Qarri, Caka, Dollani, “Komentari i Ligit Për të Drejtën Ndërkombëtare Private”, 2019, f. 711, para. 1.

së vendimit dhe jo siç parashikon neni 394(ç), gjykatat shqiptare janë investuar përpara se vendimi i huaj të ketë marrë formë të prerë.

6.5 Regjimi më i Favorshëm për Njohjen dhe Ekzekutimin e një Vendimi të Huaj

Konventa nuk pengon njohjen ose ekzekutimin e vendimeve sipas ligjit kombëtar (subjekt i nenit 6 në lidhje me pronat *in rem.*) (neni 15). Konventa e Vendimeve HCCH 2019, ashtu si Konventa e Nju Jorkut, trajton regjimin më të favorshëm, duke theksuar qëllimin e saj, që është lehtësimi i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve ndërkuftare. Duke iu referuar Raportit Shpjegues të Konventës së Vendimeve HCCH 2019, kjo dispozitë bazohet në parimin e favorizimit të njohjes (*favor recognitionis*). Nëse një vendim mund të mos njihet ose të zbatohet sipas Konventës, sepse, p.sh., ai nuk është i pranueshëm sipas nenit 5, një palë mund të kërkojë ende njohje ose ekzekutim sipas ligjit kombëtar. Me fjalë të tjera, Konventa përcakton një standard minimal për njohjen reciproke ose ekzekutimin e vendimeve, por shtetet mund të shkojnë më tej.⁴⁴

6.6 Juridiksioni i gjykatës ku është kërkuar njohja

Sipas nenit 13 paragrafi 2 i Konventës së Vendimeve HCCH 2019 “gjykata e shtetit të kërkuar nuk do të refuzojë njohjen ose ekzekutimin e një vendimi sipas kësaj Konvente me arsyetimin se njohja ose ekzekutimi duhet të kërkohej në një shtet tjetër”. Kjo dispozitë parandalon një gjykatë të refuzojë njohjen mbi bazën se, për shembull, ekziston një forum alternativ ku njohja ose zbatimi i vendimit është më i përshtatshëm. Megjithatë procedura për njohjen, shpalljen e ekzekutueshmërisë ose regjistrimin për ekzekutim dhe ekzekutimin e vendimit rregullohet nga ligji i shtetit të kërkuar, gjykatat e shtetit të kërkuar nuk mund të refuzojnë njohjen ose ekzekutimin e një vendimi sipas Konventës me arsyen se njohja duhet të kërkohej në një shtet tjetër. Në praktikë kjo parandalon mbështetjen në doktrinën e *forum non convenience* si një bazë për të refuzuar njohjen ose ekzekutimin.⁴⁵

Konventa e Vendimeve HCCH 2019 kërkon që gjykatat e Shteteve Kontraktuese të kenë juridiksion për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja. Megjithatë, kjo dispozitë nuk eklipson interesin legjitim të palës së interesuar për të njohur vendimin e huaj. Nëse gjykatat do të kënaqen me një interes aktual ose të ardhshëm, kjo i nënshtrohet parimit procedural civil të shtetit të kërkuar. Siç është shpjeguar në Raportin shpjegues dispozita i referohet rastit kur një kreditor i vendimit mund të ketë interes legjitim për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi

⁴⁴ Francisco Garcimartín & Geneviève Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters. Explanatory Report 2020, f. 146, para. 326, Shiko: <https://assets.hcch.net/docs/a1b0b0fc-95b1-4544-935b-b842534a120f.pdf>

⁴⁵ Francisco Garcimartín & Geneviève Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters. Explanatory Report 2020, f. 142, paras. 319, Shiko: <https://assets.hcch.net/docs/a1b0b0fc-95b1-4544-935b-b842534a120f.pdf>

në më shumë se një shtet dhe kërkon njohjen ose ekzekutimin e vendimit në çdo shtet.⁴⁶ Praktikisht, nëse një palë e interesuar për njohjen e një vendimi, nuk do të shfaqte ndonjë interes për të njohur vendimin në një shtet (siç ishte rasti i vendimit shqiptar në Nju Jork, Shtetet e Bashkuara dhe Irlandë), gjykata mund të mos shpallë mungesën e juridiksionit sipas nenit 13.2 të Konventës së Vendimeve HCCH 2019, por mund të deklarojë mungesën e interesit legjitim të kreditorit për njohjen e vendimit në atë shtet.

Gjykata e Apelit Tiranë ka refuzuar njohjen e një vendimi italian, ndër të tjera, për mungesë të interesit legjitim të palës kërkuese. Në praktikën gjyqësore në fjalë, pala kërkuese ishte një shoqëri tregtare daneze, e cila kishte paraqitur një kërkesë për njohjen e një vendimi italian në Shqipëri, mbi bazën se shoqëria e debitorit kishte një degë në Shqipëri. Pavarësisht se nuk ndajmë të njëjtin mendim me arsyetimin e gjykatës, çështja në fjalë thekson faktin se gjykata merr në konsideratë interesin e ligjshëm, pa e lidhur atë me juridiksionin.⁴⁷

VII. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Nga multilateralizmi i Konventës së Vendimeve HCCH 2019, vendimet shqiptare do të njihen dhe/ose do të ekzekutohen (ose refuzohen të njihen dhe ekzekutohen) në çdo Shtet Kontraktues të ardhshëm dhe anasjelltas sipas të njëjtave baza. Unifikimi i kuadrit ligjor për njohjen dhe/ose ekzekutimin e një vendimi të huaj është një garanci pozitive për investitorët e huaj në Shqipëri. Kuadri ligjor është një lloj *laisser-passez* për investitorët ose për këdo që është i interesuar të ketë marrëdhënie ekonomike ose biznesi me Shqipërinë, njëlloj si Konventa e Nju Jorkut për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, sepse ata e dinë që në fillim se çfarë i pret në çdo rast të mundshëm të ndonjë mosmarrëveshjeje në të ardhmen.

Multilateralizmi i Konventës së Vendimeve HCCH 2019 do të shmangë kërkesën e reciprocitetit (qoftë *de facto*, ose *de jure*) për njohjen dhe/ose ekzekutimin e vendimeve të huaja, e cila është e zbatueshme në disa vende. Prandaj, vendimet shqiptare mund të njihen dhe/ose të ekzekutohen lirisht në Austri (që aktualisht kërkon një reciprocitet *de jure* dhe *de facto*), Gjermani (që kërkon reciprocitet *de facto*) etj.

Unifikimi i kuadrit ligjor nëpërmjet Konventës së Vendimeve HCCH 2019 do të bëhet një histori suksesi nëse do të pasohej nga një uniformitet i zbatimit të tij.

Konventa e Vendimeve HCCH 2019 jep një arsye shtesë për t'i bërë gjykatat shqiptare të njohin juridiksionin ekskluziv të gjykatave të shteteve të tjera për çështje që lidhen me të drejta reale mbi pasuri të paluajtshme.

Ratifikimi i Konventës së Vendimeve HCCH 2019 do të shmangë zbatimin e nenit 394(ç) të KPC të Shqipërisë, i cili parashikon se: “Një vendim i huaj nuk mund të njihet në Shqipëri kur

⁴⁶Francisco Garcimartín & Geneviève Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters. Explanatory Report 2020, f. 141, para. 317, Shiko: <https://assets.hcch.net/docs/a1b0b0fc-95b1-4544-935b-b842534a120f.pdf>

⁴⁷Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr. 178, Regj. Nr.178, datë 22.11.2016.

e njëjta mosmarrëveshje, që është paraqitur përpara se vendimi i huaj të kishte marrë formë të prerë, është në shqyrtim para një gjykate shqiptare”. Sipas Konventës së Vendimeve HCCH 2019, njohja e një vendimi të huaj mund të shtyhet ose refuzohet vetëm nëse gjykatat shqiptare investohen përpara gjykatës së origjinës dhe jo siç parashikon neni 394(ç), domethënë kur gjykatat shqiptare investohen përpara se vendimi i huaj ka marrë formë të prerë.

Konventa e Vendimeve HCCH 2019, njëlloj si Konventa e Nju Jorkut, trajton regjimin më të favorshëm, duke theksuar qëllimin e saj, që është lehtësimi i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve ndërkuftare.

Duke marrë në konsideratë dispozitën kalimtare të Konventës, përkatësisht nenin 16, i cili parashikon se, “kjo Konventë do të zbatohet për njohjen dhe zbatimin e vendimeve nëse, në kohën e fillimit të procedurës në shtetin e origjinës, Konventa kishte efekt ndërmjet atij Shteti dhe shtetit ku kërkohet njohja” ratifikimi i Konventës nuk duhet të vonohet.

Si përfundim, duke pasur në konsideratë konkluzionet e mësipërme, rekomandojmë që Shqipëria të ratifikojë Konventën e Vendimeve HCCH 2019 pa rezerva, në të njëjtën mënyrë sikurse ka bërë së fundmi, më 13.02.2024, me Konventën e Hagës për Zgjedhjen e Juridiksionit me Marrëveshje e 30 qershorit 2005.

BIBLIOGRAFI

Publikime dhe raporte

David Goddard, “The Judgments Convention – The Current State of Play”, Duke Journal of Comparative & International Law, Vol. 29, 2019, Shiko:
<https://scholarship.law.duke.edu/cgi/viewcontent.cgi?referer=&httpsredir=1&article=1551&context=djcil>

Flutura Kola Tafaj, Asim Vokshi “Procedura civile”, Pjesa II, Botim II, (2018)

Francisco Garcimartín & Geneviève Saumier, Convention of 2 July 2019 on the Recognition and Enforcement of Foreign Judgments in Civil or Commercial Matters. Explanatory Report 2020, <https://assets.hcch.net/docs/a1b0b0fc-95b1-4544-935b-b842534a120f.pdf>

Jessel-Holst, Malltezi, Kola Tafaj, Gugu Bushati, Qarri, Caka, Dollani, “Komentari i Ligjit Për të Drejtën Ndërkombëtare Private”, 2019.

Julian Feichtinger & Karin Lehner, “Comparative Study of 'Residual Jurisdiction' in Civil and Commercial Disputes in the EU: National Reporter for Austria”, (European Commission, 2007), <<http://ec.europa.eu/civiljustice/news/docs/studyjresidjurisd-austriaen.pdf>>.

Julie Murphy-O'Connor & Gearoid Carey, “Enforcement of Foreign Judgments in Ireland: Irish Court of Appeal Declines Jurisdiction to Recognize and Enforce a Non-EU/EFTA Judgment where no Apparent Practical Benefit would Accrue to the Appellant”, International Corporate Rescue (2018), Shih: https://www.matheson.com/docs/default-source/practice-area-attachments/corporate-restructuring-and-insolvency/enforcement_of_foreign_judgments_in_ireland_-_irish_court_of_appeal_update.pdf?sfvrsn=f7f82d9a_2

Katharina Kitzberger & Stefan Weber, Enforcement of Judgments Austria, 2022, shih: <https://gettingthedealthrough.com/area/46/jurisdiction/25/enforcement-foreign-judgments-austria/>

Katherine Toomey & Tara J. Plochocki, “New York Appellate Court Imposes Jurisdictional Requirements in Foreign Judgment Recognition Actions”, 18 mars 2018, http://www.lbkmlaw.com/media/event/134_New%20York%20Appellate%20Court%20Imposes%20Jurisdictional%20Requirements.pdf

Knoeltz, Enforcement of Judgments, Austria, 2023 <https://practiceguides.chambers.com/practice-guides/comparison/730/11433/18397-18399-18407-18414>.

M. Zachary Bluestone, Gabriel Bluestone. “Enforcing foreign judgments in New York: Are NY Courts still favorable to foreign judgment holders? Asset Recovery Magazine, Issue 2 - The International Edition, 24 April 2019, https://informaconnect.com/article/pdfs/ef13865a-23d5-4b4d-ba44-d701032546db_AssetRecoveryMagazine-April2019-Issue2v.pdf

Markus Langen, Dr. Andreas Klein and Dominik Stier, Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve mbi vendimet e huaja – Gjermani 2023-2024, 31.03.2023, <https://iclg.com/practice-areas/enforcement-of-foreign-judgments-laws-and-regulations/germany>

Markus Langen, Dr. Andreas Klein & Dominik Stier, Procesi gjyqësor: Ekzekutimi i vendimeve të huaja në Gjermani, 2 korrik 2018, <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=f476bc5a-60f4-4f1a-9aad-22a5e11fb708>

Oriola Uka & Michael Wietzorek, Anerkennung einer deutschen Ehescheidung durch das Appellationsgericht Tirana (Gjykata e apelit Tiranë, S. 90), IPRax 2011. <https://www.iprax.de/de/inhalte/fruehere-hefte/2011-Heft-01.php>

“Përmbledhje e Projektit të Vendimeve”, shih <https://www.hcch.net/en/projects/legislative-projects/judgments/overview-judgments>.

Rolf A. Schütze, Das internationale Zivilprozessrecht in der ZPO, de Gruyter, 2011,
<https://dokumen.pub/das-internationale-zivilprozessrecht-in-der-zpo-2-neu-bearb-aufl-9783110250848-9783110250831.html>

Vendime gjyqësore të huaja

AlbaniaBEG Ambient Sh.p.k v Enel SpA 2018 NY Slip Op 00928, datë 8 Shkurt 2018,
<https://law.justia.com/cases/new-york/appellate-division-first-department/2018/152679-14-3306.html>

Albaniabeg Ambient Sh.p.k -v- Enel SpA & Anor, [2016] IEHC 139, datë 08.03.2016,
<https://www.bailii.org/ie/cases/IEHC/2016/H139.html>

Albaniabeg Ambient Sh.p.k -v- Enel SpA & Enelpower SpA; [2018] IECA 46, datë 26/02/2018, Vendim i Gjykatës Irlandeze të Apelit. Shihni në:
<https://www.bailii.org/ie/cases/IECA/2018/CA46.html>

Diaz v Galopy Corp. Intl., NV, 61 Misc. 3d 429 (Sup. Ct. NY Co. 2018)
<https://caselaw.findlaw.com/court/ny-supreme-court/1897716.html>

Vendim i Gjykatës së Apelit të Amsterdamit, date 17.07.2018, në çështjen me nr. 200.196.175/01,
<https://uitspraken.rechtspraak.nl/inziendocument?id=ECLI:NL:GHAMS:2018:3008>

Vendim i Gjykatës franceze të Kasacionit datë 17.05.2023,
<https://www.courdecassation.fr/decision/6464c680bfe1af822a1dfd71>

Vendime gjyqësore shqiptare

Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr. 288/15, Regj. nr 7, datë 28.01.2019.
Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr. 218/2, Regj. Nr.10, datë 24.01.2018.
Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 30-2018-4659, datë 27.07.2018.
Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr 207/9 Regj. nr 40, datë 23.02.2017.
Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr. 205, Regj. nr 180, datë 12.12.2017.
Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr. 178, Regj. Nr.178, datë 22.11.2016.
Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr. 60, datë 07.06.2011
Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr. 18 Regj. nr 18, datë 28.02.2008.

Website Links

<https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/?cid=137>
<https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/?cid=98>
<https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/?cid=78>